

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7968
E martë, 14 janar 2025
Çmimi 0.50 €

DREJT HUMBJES SË MADHE

FAQE 3



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ME FUSHATËN ZGJEDHORE NISIN EDHE PRITJET E QYTETARËVE PËR NDRYSHIME

FAQE 2



Investimet, puna, arsimi... Këto pak fjalë mund të dëgjoheshin nga disa qytetarë që ecnin në një shesh të zhurmshëm të Prishtinës këtë fillim-janar. Kosova, me mbi 2 milionë votues të regjistruar brenda

dhe jashtë vendit, mban zgjedhjet parlamentare më 9 shkurt. Në garë janë mbi 1 200 kandidatë, prej të cilëve do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit, dhe katër kandidatë për kryeministër: Albin Kurti i Vetëvendosjes,

aktualisht në pushtet, Bedri Hamza i Partisë Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Ramush Haradinaj i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës

LAJÇAKU: KËTË JAVË FOKUSI TE TAKIMI I PARË I KOMISIONIT TË PËRBASHKËT PËR TË ZHDUKURIT

F.3



KOZ-ja AKREDITOI GRUPIN E PARË TË VËZHguesve PËR KATËR SUBJEKTE POLITIKE PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

F.5



RRITET NUMRI I PËRDORUESVE ME KONTRATË (POSTPAID)

F.8

RRITEN ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE NË GJERMANI

F.8

SPORT



"EDON ZHEGROVA ËSHTË I ETUR PËR T'IU BASHKUAR NAPOLIT"

F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Gjermania heton spiunazhin e dyshuar rus në bazat e saj ushtarake

BERLIN, 13 JANAR - Policia gjermane tha se ka nisur një hetim për rastet e dyshuara të spiunazhit rus, pasi disa dronë u vunë re mbi disa instalime ushtarake në Bavari.

Në vazhdim të luftës së Rusisë në Ukrainë nuk përjashtohet mundësia që instalimet ushtarake gjermane dhe kompanitë e mbrojtjes të jenë duke u spiunuar nga dronët, tha Zyra Shtetërore e Hetimit Kriminal e Bavarisë.

Incidenti i fundit ndodhi të dielën vonë, kur një dron u pa

mbi një bazë ushtarake pranë Manhingut, tha policia, duke i referuar një objekti të gjerë, ku forcat gjermane testojnë avionë të rinj me pilotë dhe pa pilotë.

Dronët mbi këtë bazë u panë edhe gjatë tri ditëve në dhjetor, sipas policisë.

Një tjetër fluturim i paautorizuar ndodhi po atë muaj edhe mbi një instalim ushtarak në Nojburg an der Donau.

Policia federale e Gjermanisë, Bundeskriminalamt, i paralajmëroi kompanitë në dhjetor se mund të kenë

sabotues rusë në mesin e punonjësve dhe kontraktorëve të tyre. Por, Rusia i mohoi këto akuza.

Kreu i shërbimit të inteligjencës së jashtme të Gjermanisë, Bruno Kahl, tha muajin e kaluar se aktet e sabotimit të Rusisë kundër objektivave perëndimore mund ta shtyjnë NATO-n të thirret në Nenin 5 të traktatit të mbrojtjes. Sipas këtij neni, nëse një anëtar i NATO-s sulmohet, anëtarët e tjerë të aleancës janë të detyruar ta ndihmojnë atë që të përgjigjet.



Millanoviq rizgjidhet president i Kroacisë

ZAGREB, 13 JANAR - Zoran Millanoviq e ka fituar mandatin e dytë të presidentit të Kroacisë të dielën, sipas rezultateve të para pas numërimit të 98.65 për qind të votave.

Millanoviqi, nga partia opozitare Partia Social-Demokrate (SDP), është në rrugën e duhur për t'i fituar 74.58 për qind të votave, sipas numërimit të votave nga Komisioni Qendror Zgjedhor i Kroacisë.

Kundërshtari i tij në balotazhin e së dielës, Dragan Primorac, nga partia në pushtet, Unioni Demokratik i Kroacisë (HDZ), i ka fituar 25.42 për qind të votave.

Dalja në zgjedhjet presidenciale në Kroaci - vendin anëtar të NATO-s dhe Bashkimit Evropian - ishte 44.15 për qind, sipas të dhënave fillestare.

"Kroaci, faleminderit", tha Millanoviqi para gazetarëve.

"Kjo është një ditë e madhe për mua personalisht. Këtë fitore e shoh si njohje për punën time, një lloj besimi i popullit në mua", tha ai.

Roli i presidentit në Kroaci është kryesisht ceremonial.

Kreu i shtetit nuk mund të vërë veto ndaj ligjeve,



Kush është Zoran Millanoviq?

megjithëse ka fjalën e tij në politikën e jashtme dhe në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Gjatë mandatit të tij, Millanoviq - një ish-kryeministër populist - e ka kundërshtuar kryeministrin Andrej Plenkoviç në lidhje me politikën e jashtme dhe publike.

I parë shpesh si gjaknxehtë dhe arrogant, Zoran Millanoviq vitet e fundit e ka përdorur gjithnjë e më shumë retorikën populiste dhe shpesh fyese për ta kritikuar Bashkimin Evropian dhe zyrtarët lokalë. I diplomuar për drejtësi, ai ka

qenë një nga figurat më dominuese në politikën e Kroacisë për gati dy dekada. Si diplomat karriere në Ministrinë e Jashtme gjatë luftës së Kroacisë për pavarësi në vitet 1990, ai më vonë ka shërbyer edhe në misionin e Zagrebit në BE dhe në NATO, në Bruksel. Ai ka hyrë në politikë në vitin 1999, duke iu bashkuar Partisë Social-

Demokrate - dikur parti komuniste - dhe është bërë lidere në vitin 2007.

Millanoviqi ka shërbyer kryeministër nga viti 2011 deri më 2016. Por, qeveria e tij, e cila ka mbikëqyrur anëtarësimin e Kroacisë në BE në vitin 2013, ka dështuar t'i zbatojë reformat shumë të nevojshme, duke shkaktuar ngecje ekonomike.

Pas humbjes së SDP-së në zgjedhje, Millanoviqi është larguar nga udhëheqja e saj në vitin 2016 dhe është tërhequr nga politika për të punuar si këshilltar.

Tre vjet më vonë ai është rikthyer kandidat i kësaj partie për president.

Gjatë fushatës presidenciale, Millanoviq, 58 vjeç, i cili është marrë me boks në të 20-at, ka arritur ta mbajë kryesisht nën kontroll temperamentin e tij shpërthyes.

Ai është zotuar se do të jetë një mburojë kundër dominimit të plotë të partisë konservatore, HDZ, e cila udhëhiqet nga rivali i tij prej kohësh, kryeministri Andrej Plenkoviç. Kjo parti ka qenë në pushtet që nga viti 2016. "Kroacia nuk do të jetë një vend në të cilin një njeri vendos për gjithçka", ka shkruar ai në "Facebook", duke iu referuar Plenkoviçit.

Millanoviqi është i martuar dhe ka dy djem.

Belgjika në grevë: Anulohen fluturimet dhe udhëtimet me tren

BRUKSEL, 13 JANAR - Belgjika u përfshi nga një grevë kombëtare të hënën, pasi punonjësit e trafikut ajror dhe hekurudhor u ngritën kundër planeve për reforma të pensione.

Rreth 40 për qind e fluturimeve për dhe nga Aeroporti i Brukselit - më i madhi i Belgjikës - u anuluan, pasi bartësit e bagazheve, stafi i sigurisë dhe personeli tjetër ndërprejnë punën.

Kompania ajrore "Brussels Airlines" tha të shtunën se është detyruar të anulojë paraprakisht gjysmën e

fluturimeve të saj brenda Evropës për t'i mbajtur në funksion linjat e largëta.

Operatori i aeroportit Charleroi - që është një ndër qendrat kryesore evropiane për linjën ajrore me kosto të ulët, Ryanair - tha se priten vonesa të konsiderueshme dhe anulime të mundshme.

Transporti hekurudhor pësoi, gjithashtu, dy dëmtime në tre trena që lidhin qytetet e mëdha.

Shërbimi i trenave u ndërpre edhe në Bruksel.

Greva mbarëkombëtare u thirr nga tri sindikatat



kryesore të Belgjikës për të protestuar kundër reformave në pensione, që mund të miratohen nga qeveria e

ardhshme.

Partitë belge janë ende në bisedime për të formuar një administratë të re federale, pas zgjedhjeve që u mbajtën në qershor.

Pesë partitë që po negociojnë për të arritur një marrëveshje koalicioni, planifikojnë ta rrisin moshën e pensionit për punonjësit e hekurudhave dhe të tjerët, që tani lejohen të dalin në pension të parakohshëm, sipas sindikatës CSC.

Sindikatat planifikojnë të mbajnë edhe një demonstratë në Bruksel gjatë ditës.

Lajçaku: Këtë javë fokusi te takimi i parë i Komisionit të Përbashkët për të Zhdukurit

PRISHTINË, 13 JANAR - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, tha se fokusi i kësaj jave në Bruksel do të jetë të takimi i parë i Komisionit të Përbashkët për personat e zhdukur në luftën e fundit në Kosovë. Në postimin e bërë në "Facebook", Lajçaku nuk dha ndonjë datë konkrete për takimin.

Ky komision është pjesë e Deklaratës së Përbashkët për Personat e Zhdukur, të cilën Kosova dhe Serbia e kanë arritur në vitin 2023 në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Megjithatë, zotimet që përfshin ajo - si qasja e plotë në informacione të besueshme, vënia në dispozicion e të gjitha dokumenteve me rëndësi për përcaktimin e fatit të personave të zhdukur dhe puna e përbashkët përmes një komisioni të kryesuar nga

BE-ja - kanë mbetur pa u zbatuar.

Në takimin e fundit në Bruksel më 17 dhjetor të vitit të kaluar, kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, dhe ai i Serbisë, Petar Petkoviç, kanë thënë se janë pajtuar për zbatimin e plotë të Deklaratës për Personat e Zhdukur, raporton REL.

Në atë rast, Bislimi ka konfirmuar se Komisioni i Përbashkët do të fillojë të merret me çështjet në fjalë që nga janari. "Ka premtime nga Serbia se nuk do të ketë tendenca që të pengohet puna e këtij komisioni në të ardhmen", ka thënë atëkohë Bislimi.

Petkoviç, në anën tjetër, ka thënë se është ndërmarrë "hapi i fundit i nevojshëm" për çështjen e personave të zhdukur. "Kemi Deklaratën, kemi rregulloren e punës dhe tani kemi rënë dakord për një komision të përbashkët që do ta mbështesë grupin e punës,



të cilin, si deri tani, e kryeson Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq", ka thënë ai. Sipas Kryqit të Kuq, janë ende 1 612 persona të pagjetur nga lufta e viteve 1998/99 në Kosovë - shumica prej tyre shqiptarë.

Kosova dhe Serbia vazhdimisht e kanë bërë përgjegjëse njëra-tjetrën për mungesën e përparimit për kërkimin e të zhdukurve. Varreza e fundit masive është zbuluar në vitin 2020 në vendin e ish-minierës

Kizhevak, afër Rashkës, në jug të Serbisë. Ajo ka qenë varreza e pestë masive që është zbuluar në territorin e Serbisë që nga viti 2001.

Para gjykatave në Serbi, deri më tash, askush nuk është mbajtur përgjegjës për lëvizjen dhe fshihjen e trupave të shqiptarëve të Kosovës.

Ish-shefi i Departamentit të Sigurisë Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë, Vllastimir Gjorgjeviç, është dënuar nga gjykata në Hagë me 27 vjet burgim për krime në Kosovë, përfshirë lëvizjen e trupave dhe varrosjen e tyre në varre të fshihura. Në aktgjykim thuhet se transporti është kryer si pjesë e një operacioni të koordinuar për largimin e dëshmitarëve të krimeve të kryera nga forcat serbe kundër shqiptarëve të Kosovës.

Dënimi i Gjorgjeviçit më vonë është shkurtuar në 18 vjet dhe ai po e vuan atë në një burg në Gjermani.

Gjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Prokuroria ka edhe 72 dëshmitarë

PRISHTINË, 13 JANAR - Ekipi i prokurorëve në rastin e katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare, Hashim Thaçit dhe të tjerëve, të akuzuar për bashkëveprim në krime lufte, ka në listë edhe 72 dëshmitarë për ta përmbyllur çështjen e saj. Megjithatë në mars do të vendoset nëse prokuroria do të shtojë dëshmitarë të rinj në listën e saj fillestare prej më shumë se 320.

Zyra e Prokurorit të Dhomave të Specializuara pritet të vendosë në mars nëse do të thërrasë dëshmitarë shtesë në rastin e ish-krerëve të lartë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit, të akuzuar për bashkëveprim në krime lufte.

Për 72 dëshmitarët e mbetur, zëdhënësja e Dhomave të Specializuara, Angela Grip, i ka thënë "Radio Kosovës" se në konferencat e ardhshme statusore do të vendoset se sa



prova do të pranohen me shkrim dhe sa dëshmitarë duhet të paraqiten në gjykatë, përderisa avokati i viktimave

do t'i paraqesë rastet e tyre. "Prokurori specialist, natyrisht, mund të vendosë edhe heqjen e dëshmitarëve

shtesë. Së pari, dhe më kryesorja, ekipet e mbrojtjes do të pyeten nëse duan të paraqesin një kërkesë për

heqjen e disa ose të gjitha akuzave", ka thënë Grip.

Avokati Lluka Mistic, që kryeson ekipin e mbrojtës së ish-presidentit Hashim Thaçi, i ka thënë "Radio Kosovës" se nuk kanë paraqitur ende listën e dëshmitarëve që duhet të hiqen dhe as të dëshmitarëve të mbrojtjes. Në këtë pikë, palët ende janë të fokusuar të sigurohen se prokuroria të mund ta mbyllë çështjen e saj brenda afatit të rënë dakord në prill të këtij viti.

Zyra e Prokurorit të Dhomave të Specializuara në Hagë kishte paraqitur një listë të dëshmitarëve të prokurorisë me 323 dëshmitarë nga të cilët deri më tani kanë dëshmuar 110 persona në sallën e gjykatës apo kanë qenë në dispozicion për t'u marrë në pyetje. Gjithashtu, 86 dëshmitarë janë pranuar vetëm në formë të shkruar, përderisa 55 dëshmitarë të tjerë janë hequr nga lista fillestare./rtk/

Bislimi pret në takim të ngarkuarën me punë në Ambasadën e ShBA-së, bisedojnë për pritshmëritë e 9 shkurtit

PRISHTINË, 13 JANAR - Zëvendëskryeministri i Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, mirëpriti ditën e sotme në takim të ngarkuarën me Punë në Ambasadën e ShBA-së në Kosovë, Anu Prattipati. Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se në këtë takim ata

biseduan rreth partneritetit Kosovë - ShBA dhe për fuqizimin e thellimin e marrëdhënieve mes dy shteteve tona. Sipas njoftimit, temë e diskutimit ishin edhe zgjedhjet e ardhshme e fushata e cila sapo ka filluar dhe pritshmëritë e 9 shkurtit. "Në takim u trajtua dhe bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet fqinjësore dhe

procesi i dialogut e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Zëvendëskryeministri e falënderoi Prattipati për bisedën e sotme e bashkëpunimin e vazhdueshëm, duke shprehur mirënjohjen për përkrahjen e shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj Kosovës", thuhet në njoftim.





Me fushatën zgjedhore nisin edhe pritjet e qytetarëve për ndryshime

Investimet, puna, arsimiti... Këto pak fjalë mund të dëgjoreshin nga disa qytetarë që ecnin në një shesh të zhurmshëm të Prishtinës këtë fillim-janar. Kosova, me mbi 2 milionë votues të regjistruar brenda dhe jashtë vendit, mban zgjedhjet parlamentare më 9 shkurt. Në garë janë mbi 1 200 kandidatë, prej të cilëve do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit, dhe katër kandidatë për kryeministër: Albin Kurti i Vetëvendosjes, aktualisht në pushtet, Bedri Hamza i Partisë Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Ramush Haradinaj i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës

PRISHTINË, 13 JANAR - Investimet, puna, arsimiti... Këto pak fjalë mund të dëgjoreshin nga tri gra që ecnin në një shesh të zhurmshëm të Prishtinës këtë fillim-janar. Me t'u afruar mikrofonin e "Radios Evropa e Lirë" ato nuk hezituan të tregonin se po flisnin për zgjedhjet e 9 shkurtit. "Një e ardhme më e mirë për vendin", thanë se është dëshira e përbashkët e tyre. E kjo, sipas njëres prej tyre, do të mund të arrihej vetëm me ringjalljen e industrisë. "Të gjitha fabrikat janë mbyllur. Pajisjet në to kanë qenë të vjetruara, por me kohë kanë mundur të modernizohen dhe të krijohen mundësi punësimi për brezat e rinj", u shpreh Hikmete Xharra, profesoreshë

në pension e Gjuhës Angleze. Kosova, me mbi 2 milionë votues të regjistruar brenda dhe jashtë vendit, mban zgjedhjet parlamentare më 9 shkurt. Në garë janë mbi 1 200 kandidatë, prej të cilëve do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit, dhe katër kandidatë për kryeministër: Albin Kurti i Vetëvendosjes, aktualisht në pushtet, Bedri Hamza i Partisë Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Ramush Haradinaj i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Fushata e tyre për t'i bindur qytetarët që të votojnë, nisi zyrtarisht më 11 janar. Për Nazmije Kaçin, kushdo që të fitojë, do të duhej të angazhohej më shumë për

tërheqjen e investimeve të huaja në ndërmarrje të ndryshme të Kosovës. Si inxhinierë e fizikës ajo tregoi se ka punuar me vite në Minierën e Kishnicës, e cila deri në vitet '90 ishte një prej motorëve të ekonomisë së Kosovës, por edhe të Jugosllavisë së atëhershme në përgjithësi.

Sot kjo minierë, e cila gjendet në magjistralen Prishtinë - Gjilan, punon me kapacitete të reduktuara, pikërisht për shkak të pajisjeve të vjetruara dhe mungesës së investimeve.

Nazmija beson se vitet e fundit janë krijuar kushte më të mira të sigurisë për investime të huaja. "Veriu [zonë e banuar me shumicë serbe] është më i sigurt. Investitorët e huaj e kanë më lehtë të investojnë, por nevojitet angazhim i institucioneve", sipas saj. Vetë pensioniste, ajo nuk e lë pa përmendur as këtë kategori të shoqërisë, përfitimet mujore të së cilës variojnë - 120 euro janë pensionet e moshës dhe 218 deri në 318 euro janë pensionet për kontributpaguesit. "Pensionet duhet të rriten deri në 500 euro në muaj. Kjo shumë do të siguronte një mirëqenie më të mirë për pensionistët. Shuma që marrim tash është shumë e vogël", sipas Nazmijes.

Në bisedë u përfshi edhe shoqja e tyre. "Kosova nuk ka ende Shtëpi të Operës dhe Baletit", tha shkurtimisht ajo. Zgjedhjet e 9 shkurtit janë të parat të rregullta që do të mbahen në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë, më 2008. Kushdo që i fiton ato, sipas Florim Gashit, do të duhej ta kishte prioritet arsimin. "Arsimi është ai trangu që shpërndan gjithçka", sipas tij. Vetë mësimdhënës për më shumë se dy dekada në qytetin e Podujevës, ai ankohet për cilësinë e ulët në arsim, e cila shpesh është përmendur edhe në raporte dhe vlerësime të ndryshme ndërkombëtare. "Duhet të bëhen reforma dhe në qendër të jetë mësuesi, e jo dikush tjetër... sepse në pozita udhëheqëse po vijnë njerëz politikë dhe joprofesionalë", u shpreh ai.

Një tjetër çështje me rëndësi, sipas tij, është edhe siguria në çdo anë të Kosovës, përfshirë edhe pjesën veriore të banuar me shumicë serbe, ku shpesh ka trazira. "Shih sa bukur është në sheshin e Prishtinës. Liria e lëvizjes është e rëndësishme për qytetarët", u shpreh mësimdhënësi. Në sheshin ku po shëtiste ai, REL-i takoi edhe Artan Gjinnicën, i cili jeton në Shtetet e Bashkuara, por po vizitonte Kosovën për festat e fundvitit. Ai tha se është regjistruar për të votuar me

postë nga ShBA-ja. Për Artanin askush nuk duhet të bëjë premtime boshe, por të sigurojë zhvillim të vërtetë të vendit.

Partia që ka vendosur ta votojë ai, tha se "e ka treguar veten" dhe prej saj tani pret që të bëjë më shumë në luftimin e korrupsionit dhe rritjen e punësimin.

Kosova, me 1.6 milion banorë të regjistruar, ka shkallën e papunësisë në rreth 10 për qind.

Paga mesatare në vend është 570 euro.

Sipas një vlerësimi të Bankës Botërore, rritja ekonomike këtë vit do të jetë më pak se 4 për qind.

Shumë parti politike dhe kandidatë të tyre ka kohë që kanë nisur të bëjnë fushatë, qoftë me vizita në qytete të ndryshme të Kosovës dhe jashtë saj, qoftë me paraqitje të vazhdueshme televizive.

Ata përpiqen ta fitojnë besimin e 2 075 868 votuesve të regjistruar, duke premtuar investime në arsim, shëndetësi, ekonomi, infrastrukturë, bujqësi e sport, por edhe rritje të pagave dhe pensione.

Qytetarët që biseduan me REL-in thanë se planifikojnë të votojnë, por nëse pritjet e tyre do të përmbushen, mbetet për t'u parë.

Premtime të ngjashme ata kanë dëgjuar edhe më herët.

Kushte të vështira atmosferike në Kosovë, thirrje për kujdes gjatë ngasjes

PRISHTINË, 13 JANAR - Një ciklon i fuqishëm që ka origjinën nga jugu i Italisë dhe rajoni i Detit Jon ka përshkuar Shqipërinë dhe Kosovën, duke sjellë reshje intensive dhe një rënie të ndjeshme të temperaturave në të gjithë vendin. Kjo situatë meteorologjike ka shkaktuar ngrica dhe ka përkeqësuar kushtet për qarkullim, duke e bërë udhëtimin në disa zona më të vështirë.

Si pasojë e reshjeve të borës dhe ngricave, rrugët janë të mbuluara me to dhe po krijojnë vështirësi për drejtuesit e automjeteve.

Policia e Kosovës u bënë thirrje për kujdes të shtuar gjatë

ngasjes në rrugë shoferëve, duke i këshilluar ta përshtatin shpejtësinë me kushtet atmosferike dhe ta mbajnë distancën e sigurisë mes mjeteve.

Po ashtu, është e rëndësishme që automjetet të jenë të pajisura me mjete dimërore për ta garantuar sigurinë e qarkullimit.

Autoritetet rekomandojnë kujdes për këmbësorët dhe personat e moshuar, të cilët mund të përballen me rrezik të shtuar për rrëshqitje dhe incidente në rrugë.

Këshilla për shoferët: Mbani distancën e sigurisë mes mjeteve; Përshtatni

shpejtësinë me gjendjen e rrugës; Pajisuni me goma dhe mjete dimërore; Shmangni udhëtimet e panevojshme, veçanërisht në kushte të vështira moti.

Policia e Kosovës thekson se siguria e qytetarëve është prioritet dhe kujdesi i shtuar është kyç për shmangien e aksidenteve dhe ruajtjen e jetës.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka njoftuar se situata e tillë e motit pritet të vazhdojë gjatë tërë javës, ku temperaturat minimale do të sillen nga -8 deri në -3 gradë celsius, kurse maksimalet do të arrijnë deri në 4 gradë celsius.



KQZ-ja akreditoi grupin e parë të vëzhguesve për katër subjekte politike për zgjedhjet parlamentare



PRISHTINË, 13 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka akredituar grupin e parë të vëzhguesve të subjekteve politike të certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 9 shkurt. Në mbledhjen e KQZ-së u njoftua se bëhet fjalë për 2 274 vëzhgues, të cilët u takojnë katër subjekteve të ndryshme politike, PDK-së 95 vëzhgues, LDK-së 1 725 vëzhgues, Koalicija Vakrat 234 vëzhgues, si dhe Demokratska Stranka 220 vëzhgues.

Subjektet politike të certifikuar, OJQ-të,

organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mediet si dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, mund ta dorëzojnë online kërkesën e tyre për akreditimin e vëzhguesve brenda afateve si në vijim: Afati për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve politike të certifikuar do të përfundojë më 15 janar 2025; Afati për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve të OJQ-ve vendore do të

përfundojë më 25 janar 2025; Afati për dorëzimin e kërkesave për akreditimin e vëzhguesve të organizatave qeveritare - ndërqeveritare do të përfundojë më 25 janar 2025; Afati për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e medieve vendore dhe ndërkombëtare do të përfundojë më 4 shkurt 2025; Afati për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve të përfaqësive të vendeve të huaja do të përfundojë më 25 janar 2025; Afati për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve të organizatave ndërkombëtare

do të përfundojë më 25 janar 2025. Për ta lehtësuar aplikimin, KQZ-ja ka funksionalizuar platformën online: <https://apliko.kqz-ks.org>

Si bëhet aplikimi?

Hapi i parë: Përfaqësuesi i autorizuar (i organizatës joqeveritare, organizatës qeveritare/ndërqeveritare, organizatës ndërkombëtare të specializuar në zgjedhje dhe të drejtat e njeriut; medieve; dhe përfaqësuesi i vendeve të huaja) duhet të plotësojë

online të dhënat që kërkohen në platformën: <https://apliko.kqz-ks.org>. Hapi i dytë: Pas aplikimit, Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP) do të shqyrtojë dhe do të miratojë ose jo aplikimin fillestar. Pas vërtetimit të aplikimit, ZRCKFSP, do t'i përcjellë përmes e-mailit përfaqësuesit të autorizuar kredencialet për t'u qasur në platformën online në mënyrën që t'i bashkëngjisë edhe të dhënat për personat e organizatës/medias që kërkon të akreditohen.

Prokuroria e Ferizajt gjatë vitit 2024 ngriti 231 aktakuza për dhunë në familje

FERIZAJ, 13 JANAR - Prokuroria Themelore në Ferizaj gjatë vitit 2024 ka pranuar 275 kallëzime penale kundër 275 personave lidhur me veprat penale të dhunës në familje. Ndërsa gjatë vitit 2024 nga

kjo Prokurori janë ngritur 231 akte akuzuese për veprat penale të dhunës në familje ku 214 viktima kanë qenë të gjinisë femërore dhe 61 të gjinisë mashkullore.

Po ashtu, në njoftimin për

medie nga kjo Prokurori bëhet me dije se gjatë vitit 2024 janë parashtruar 56 kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit në gjykatën kompetente. "Prokuroria Themelore në Ferizaj do të vazhdojë t'i

trajtojë me seriozitet të gjitha rastet e dhunës në familje, duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për t'i parandaluar dhe luftuar veprat penale të kësaj natyre", thuhet më tutje në njoftim.



DREJT HUMBJES SË MADHE



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Fushata apo sfilata: Fushata për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 ka hyrë në rrethin e fundit shkaku se kishte filluar thuaja para tre muajsh. Aktivitetet përqendroheshin kryesisht në diasporë ku opozita kishte pësuar humbje brutale në zgjedhjet paraprake. Tash duket se kanë mbledhur mend dhe, si rezultat, tehu goditës i LV-së në diasporë është topitur bukur shumë. LDK-ja ka deklaruar se ka të regjistruar mbi 40 000 votues që janë pjesë e kësaj partie, kurse PDK-ja nuk përmend shifra konkrete por, krahasuar me zgjedhjet e fundit, duket se është forcuar shumë. AAK - NISMA nuk është se kanë shumë votues në diasporë. LV-ja shpreson se diaspora do të jetë hambar i votave andaj ka forcuar punën me diasporën, duke e shkelur edhe Ligjin për Zgjedhje. Flitet se biznesmenët të afërt me LV-në po investojnë mjete të konsiderueshme për t'i sjellë votuesit nga diaspora në Kosovë më 9 shkurt 2025. Por, përfundimisht, diaspora më nuk është eldorado e votave për LV-në. Votat nga diaspora në rastin më të mirë për LV-në do të sillen kah 40 për qind e që do të ishte shembje e madhe krahasuar me zgjedhjet e vitit 2021.

Po brenda Kosovës, si po ecën fushata: Partitë opozitare kanë investuar shumë në hapjen e fushatës duke i dhënë më shumë rëndësi pamjes, se përbajtjes së fushatës. PDK-ja mbushi sallat dhe hapësirat jashtë sallave në Prishtinë dhe Ferizaj sikur që edhe LDK-ja

mbushi sallën në Prishtinë. AAK - NISMA mbushën sallën në Prishtinë kurse Koalicioni për Familjen e hapi fushatën në Arenën e Klan Kosovës me një kapacitet të reduktuar duke sjellë si "përforsim dhe përfitues" ambasadorin Wolker i cili në fushata ka shkuar sipas ofertës që i kanë bërë, thjesht, si lobist. Dihet mirë se lobistët nuk angazhohen për ju shkaku se i kenë sytë e zi. Po, në rastin konkret WW nuk i siguron Koalicionit për Familje as edhe një votë të vetme. VV-ja e nisi fushatën në vendlindjen e Mimoza Kusarit, Arbërie Nagavci, Oliver Ivanoviqit dhe Milan Radoiçiqit, në Gjakovën e Bajram Currit dhe Demë Ali Pozharit. Kjo, më së miri e vërteton thënien se: "historia në disa raste përsëritet si farsë...". KM në ikje, Albin Kurti bëri dy gabime në hapa që janë në kundërshtim me normat elementare morale. I pari ishte kur shkoi në drekë të Ferdonije Querkezi e cila përjetoi tragjedi personale dhe familjare sepse iu morën me dhunë nga forcat serbe i shoqi dhe katër djemtë. Nuk e di çka ka mundur t'i thotë Albin Kurti Ferdonije Querkezit që t'i zbusë dhimbjet dhe ankthin përveç ndonjë premtimi që kurrë nuk do të përmbushet mësa ishte përmbushur ai i zgjedhjeve të vitit 2021. Atentati i dytë kundër normave të moralit elementar ishte përmendja e "zdravo" të Avdullah Hotit në takim me Vuçiqin në Uashington në kohën kur Zdravo Mimoza ishte në krahun e djathtë të Kurtit.

Abdullah Hoti këtë "zdravo" e kishte thënë botërisht kurse Zdravo Mimoza kishte biseduar ilegalisht, me urdhër të Kurtit, pa asnjë dyshim, në seriale me Simiqin dhe Radoiçiqin kundër veteranëve të luftës, UÇK-së dhe rritjes së pagës minimale. Zdravo Mimoza e dinë çka dhe sa herë ka biseduar me zemljakun dhe vëllaun - brat, Radoiçiqin. Por, i kanë rënë në fije se çdo bisedë të tillë po e arsyetojnë se është e montuar si luftë hibride. Të poshtë dhe të pafytyrë. Albin Kurti, si frontman i VV-së krejt strategjinë e fushatës po e ndërton mbi urrejtjen e atyre që e formuan UÇK-në, e udhëhoqën dhe fituan luftën, e shpallën pavarësinë, ndërtuan shtetin duke i siguruar legjitimitetin ndërkombëtar dhe siguruan paqen e që tani, ose janë dënuar nga Gjykata Speciale Raciste në Hagë, ose janë duke u gjykuar, si pengje politike. Këtë urrejtje po e shpërfaq në çdo takim, si pjesë e një strategjie mirë të menduar. Albin Kurti e di se pjesa më e madhe e votuesve të përbetuar që i ka janë kundër UÇK-së dhe me një të kaluar jugosllave prandaj ua ofron menynë me vetëm një ushqim, urrejtjen kundër luftës dhe UÇK-së. Dhe më besoni se me këtë urrejtje fiton vota shkaku se votuesit me të kaluar jugosllave dhe serbe nuk kanë as identitetet e as histori kombëtare. Ashtu janë edhe oportunistët dhe frikacakët që duke përkrahur Kurtin, duan ta rikrijojnë një identitet të munguar shkaku se kanë

deficitit të patriotizmit, moralit elementar dhe njerëzores. Opozita po sillet sikur të ketë të bëjë me votues të emancipuar politikisht që voton sipas bindjes dhe duke u mbështetur në programet politike apo projektet ekonomike, sociale dhe zhvillimore. Ma gjeni sot një ministër të qeverisë Kurti që ka një të kaluar kombëtare hiç ata që patriotizmin e kanë të trashëguar e që e kanë keqpërdorur brutalisht për vota dhe pushtet. Opozita nuk mund dhe nuk duhet të sillet si gjenj në mesin e ujve dhe hienave. Kjo është rregull elementar i mbijetesës fizike dhe politike. Albin Kurti i ka shpërfillur të gjithë ata që e përkrahën dhe e sollën në pushtet, mos të them se i ka tradhtuar pabesisht sikur që po sillet me mediet kryesore që dje pamëshirshëm sulmonin liderët e luftës dhe brutalisht ia shtronin rrugën me dafina Kurtit shkallëve drejt majave të pushtetit. Këto media kanë dashur ndryshimin, ja ku e kanë.

Ka ministra dhe zv/ministra të Kurtit që para organeve serbe kanë dhënë deklarata para të cilave do të turpërohej edhe vet Nazim Bllaca. Albin Kurti po e forcon fjalorin e urrejtjes dhe përçarjes kundër vlerave kombëtare, në emër të kombëtares që në VV përjashtuar pak rasteve as që ekziston. Flamuri dhe Hymni Kombëtar janë perde tymi dhe zhurmues për votuesit shkaku se kjo garniturë sunduese nuk ka asgjë të përbashkët as me Flamurin Kombëtar e as me

Shqipërinë. Përveç urrejtjes dhe glorifikimit të antikombëtares dhe Muzës së hajdutëve, Babushkës Mihali dhe anarkistëve të Tiranës. Jam i sigurt se Albin Kurti, nëse mbijeton 9 shkurtin përmes një koalicioni sepse vet, bashkë me Listen Serbe dhe pakicat joserbe nuk do të ketë mundësi ta formojë qeverinë, do të ngjajë në një tullumbace të liruar nga ajri, do të zbutet e të bëhet Orhan Pambuk (sipas akademikes Nagavci), sidomos me ndërkombëtarët. Albini po përballlet me dy probleme kryesore, i pari është 20 janari kur ikën Bajdeni e po vjen Trampi dhe e dyta se ekziston rreziku objektiv që pas 9 shkurtit të ngelë në opozitë ku do të fillonin vuajtjet e Tantalit për Kurti. Nëse në ndërkohë nuk do të ketë zhvillime të paparashikuara.

Rezultatet e projektuara: Rritjen më të madhe do ta ketë LDK-ja sepse edhe rënien e kishte më të madhe. LDK-ja nëse mbetet nën 20 për qind do të jetë humbëse. PDK-ja mund të rritet 3 - 5 për qind, AAK- NISMA nuk mbetet nën 10 për qind, maksimumi shkon në 13 për qind. Koalicioni për Familjen do të ecë në tehtë shpatës WW, vetëm iu humbë vota prandaj mjafton t'ia paguajnë hotelin, biletën e aeroplanit dhe mëditjet, nëse duan ra përmbushin synimin. Për aq sa do të rriten subjektet garuese nga opozita, për aq do të shembet VV-ja. Do të jenë me interes të veçantë koalicionet e mundshme. Herën tjetër.

Sekuestrohen pako me cigare në Aeroportin e Prishtinës

PRISHTINË, 13 JANAR - Policia e Kosovës, saktësisht zyrtarët kufitarë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, si rezultat i implementimit të planeve operative dhe angazhimeve shtesë për identifikimin dhe parandalimin e kontrabandës në aeroport, kanë realizuar disa veprime konkrete mbi dyshimet e bazuara për kontrabandim të duhanit/cigareve, të cilat përmes Kosovës kanë tentuar të destinohen kryesisht në Mbretërinë e Bashkuar. "Si rezultat i angazhimeve dhe veprimeve policore vetëm

përgjatë muajve dhjetor 2024 - janar 2025, janë identifikuar katër raste të kontrabandimit me duhan/cigare, ku persona të dyshuar me shtetësi të huaj dhe të Kosovës, kanë tentuar që të kontrabandojnë pako/shteka me cigare prej sasive të ndryshme, për në qytetin e Londrës", thuhet në njoftim. Më tej bëhet me dije se në rastin e fundit të ndodhur me datën 11 janar 2025 është parandaluar kontrabandimi i 41 pakove/shtekave me cigare, të cilat i dyshuari mashkull, shtetas bullgar, ka tentuar përmes Kosovës t'i

kontrabandojë në Londër, pasi destinimi i tij ishte për në këtë qytet. Në këto katër raste Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, ka sekuestruar mbi 340 pako/shteka me cigare të llojeve të ndryshme, kryesisht të llojeve të shtrenjta. Policia e Kosovës së bashku me institucionet kompetente njofton opinionin dhe qytetarët se ka rritur angazhimet dhe praninë e saj në kontrollet e pasagjerëve, tek të cilët ka dyshime për kontrabanda të tilla.



Enver Hoxhaj me plan konkret për rikthimin e njohjeve ndërkombëtare: Është prioritet i lartë



PRISHTINË, 13 JANAR - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, tani kandidat për deputet i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka shpalosur planin konkret të partisë së tij për rikthimin e njohjeve ndërkombëtare të Kosovës. Në një video të publikuar, Hoxhaj ka theksuar rëndësinë jetike të njohjeve ndërkombëtare për Kosovën, duke kujtuar suksesin e tij si ministër, kur Kosova siguroi 117 njohje. Ai ka kritikuar qeverisjen aktuale të Albin Kurtit, duke vënë në pah se gjatë katër viteve të fundit nuk është

arritur asnjë njohje e re. "Jam shumë krenar që gjatë dy mandateve të mia si ministër i Punëve të Jashtme, Kosova është njohur nga një numër i madh i vendeve në gjeografi globale. Unë e kam marrë Ministrinë e Punëve të Jashtme me 75 njohje dhe e kam lënë me 117. Gjatë katër viteve të qeverisjes së Albin Kurtit nuk ka asnjë njohje të vetme", tha Hoxhaj. Ai deklaroi se PDK-ja ka hartuar një plan të hollësishëm, i cili përfshin identifikimin e vendeve potenciale në Afrikë, Azi dhe Amerikë Latine që mund ta

njohin Kosovën. "Nën udhëheqjen e Partisë Demokratike të Kosovës ne kemi një plan të qartë, një mendim të plotë dhe një analizë të hollësishme se cilat vende në Afrikë, Azi, në Amerikë Latine janë në gjendje ta njohin Kosovën. Nga java e parë, nga muaji i parë dhe nga viti i parë ne do të sjellim njohje konkrete për Republikën e Kosovës", shtoi ai. Hoxhaj paralajmëroi për një video të veçantë në të cilën do të flasë për planin për anëtarësimin e Kosovës në NATO.

Stavileci: Tubimet në Prishtinë e Ferizaj treguan se Kosova është gati për të ardhme më të mirë

PRISHTINË, 13 JANAR - Pasi Partia Demokratike e Kosovës (131) nisi fushatën zgjedhore me dy tubime madhështore në Prishtinë dhe Ferizaj, zëdhënësi i fushatës, Blerand Stavileci, në një konferencë për medie, ka thënë se këtë fundjavë ka filluar një kapitull i ri shprehe, vendosmërie dhe uniteti për Kosovën. Stavileci, duke i falënderuar qytetarët për përkrahjen dhe pjesëmarrjen masive në tubimet e PDK-së në Prishtinë dhe Ferizaj, u ka kërkuar falje të gjithë atyre që mbetën

jashtë sallave për shkak të hapësirave të kufizuara. "Të shtunën në Prishtinë dhe të dielën në Ferizaj mijëra qytetarë u bashkuan krah për krah, brenda dhe jashtë sallave, për të përcjellë dhe për të përcuar një mesazh të qartë: Kosova është gati për një të ardhme më të mirë. Kjo nuk është thjesht një fushatë. Ky është një mision dhe, mbi të gjitha, një rrugëtim i pandalshëm i atyre qytetarëve që besojnë se 'Kosova mundet ma mirë'", ka thënë ai. Sipas Stavilecit, Kosova po flet

me porosi të qartë se është koha për ta rikthyer dinjitetin, se është koha për më mirë. "Ta shkruajmë së bashku kapitullin tjetër të madh të shtetit dhe të ardhmes sonë. Prandaj, për çdo qytetar, bashkohuni me ekipin fitues të PDK-së dhe të Bedri Hamzës. Të ecim përpara, të bashkuar dhe të pandalshëm, drejt një Kosove më të mirë. Fushata ka nisur. Vrulli është i pandalshëm. 'Kosova mundet ma mirë' dhe me përkrahjen tuaj do ta bëjmë ma mirë!", ka kërkuar ai.



Ushtarët gjermanë dhe letonezë patrollojnë në veri

MITROVICË, 13 JANAR - Ushtarët gjermanë dhe letonezë, të caktuar në Komandën Rajonale Lindje të KFOR-it, zhvilluan një patrullim të përbashkët në veri të Kosovës. "Patrullimi së bashku lejon që ushtritë e dy vendeve të punojnë së bashku për të rritur sigurinë në të gjithë Kosovën", thuhet



në njoftimin e KFOR-it në "Facebook". Aty thuhet se këto përpjekje janë pjesë e misionit ditor të KFOR-it për t'i mbështetur të gjitha komunitetet brenda Kosovës. "Ushtarët gjermanë dhe letonezë të caktuar në Komandën Rajonale Lindje të misionit KFOR, të udhëhequr nga NATO,

zhvilluan një patrullim të përbashkët në veri të Kosovës. Patrullimi së bashku lejon që ushtritë e dy vendeve të punojnë së bashku për ta rritur sigurinë në të gjithë Kosovën. Këto përpjekje janë pjesë e misionit ditor të KFOR-it për t'i mbështetur të gjitha komunitetet brenda Kosovës", thuhet në njoftim.

Rritet numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid)

Prishtinë, 13 janar - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit për muajin nëntor 2024.

Në muajin nëntor 2024 numri i fluturimeve të realizuara ishte 995, ose 39,6 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i

udhëtarëve në total ishte 311 220, ose 38 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (nëntor 2023).

Transporti hekurudhor: Në muajin nëntor 2024 numri i udhëtarëve ishte 5 526, ose 4,4 % më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa sasia e mallrave të transportuara në neto ton ishte

zero.

Telefonia fikse: Në muajin nëntor 2024 numri i përdoruesve të rrjetit telefonik fiks ishte 67 732, ose 2,4 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa trafiku i realizuar (në minuta) ishte 2 129 723, ose 37,1 % më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (nëntor 2023).

Telefonia mobile: Në muajin nëntor 2024 numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1 493 074, ose 0,6 % më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid) ishte 312 041 ose 7,1 % më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



Rriten çmimet e energjisë elektrike në Gjermani

BERLIN, 13 JANAR - Në Gjermani energjia elektrike është më e shtrenjta në Evropë. Kjo rëndon konsumatorët dhe ekonominë e dobësuar. Politikanët po kërkojnë një zgjidhje.

Në fillim të vitit kishte shumë erëra, impiantet punuan me të gjitha kapacitetet. Gjatë vitit kishte edhe shumë diell. Ndaj, sipas të dhënave të Institutit Fraunhofer për Sistemet e Energjisë Diellore në Gjermani, prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme arriti 125 për qind të nevojave.

Prodhimi i tepërt shkaktoi edhe rënie drastike të çmimit të energjisë elektrike në bursa. Kishte gjatë ditës edhe energji elektrike falas për disa orë.

Vitin e kaluar burimet e rinovueshme mbuluan 59 për qind të nevojës për energji elektrike, por prodhimi është shpesh shumë më i ulët në dimër. Për shembull, më 12 dhjetor 2024 vetëm 18 për qind e totalit të energjisë elektrike të kërkuar për Gjermaninë vinte nga burime të rinovueshme. Pjesa tjetër e nevojave është mbuluar nga termocentralet me qymyr ose gaz, si dhe nga importi i energjisë elektrike. Çmimi i një megavati orë në bursë shkoi në 936 euro, ndërsa çmimi normal është nga 60 deri në 100 euro.

Tarifat

Konsumatorët privatë, si dhe kompanitë me kontrata afatgjatë, nuk i ndiejnë shumë këto luhajtje të çmimeve. Ata paguajnë një çmim fiks për një periudhë kohore të përcaktuar në kontratë, por që nga fillimi i këtij vit

distributorët e energjisë elektrike duhet të ofrojnë tarifa të tjera. Kjo duhet t'i inkurajojë konsumatorët e mëdhenj që ta drejtojnë konsumin e tyre në periudhën kur energjia elektrike është e lirë për shkak të shpenzimeve. Instituti Federal për Parandalimin e Formimit të Karteleve shtrroi pyetjen nëse rritja e çmimeve është gjithmonë vetëm rezultat i prodhimit të reduktuar të burimeve të rinovueshme. Nëse ky institucion zbulon se prodhuesit kanë arritur marrëveshje për çmimin, atëherë mund t'i gjobisë pjesëmarrësit në marrëveshje. Presidenti i Institutit, Andreas Munt, bëri me dije se do të kontrollohen rritjet e mëdha të çmimeve për shkak të dyshimeve për keqpërdorime, për të ndikuar në rritjen e çmimeve me ofertë të reduktuar. Munt thotë se Gjermania duhet të kalojë dimrin me një numër të reduktuar të termocentraleve për herë të parë, ndaj mund të pritet një rritje e re e çmimeve, e cila mund të jetë rezultat i një mekanizmi normal të tregut. "Por, për të qenë të sigurt, ne do të rishikojmë formimin e çmimeve", shtoi Munt.

Pasojat e braktisjes së qymyrit dhe energjisë atomike

Reduktimi i numrit të termocentraleve është rezultat i vendimit politik për të hequr dorë nga energjia me qymyr. Vitin e kaluar prodhimi i energjisë elektrike në bazë të linjitet ka rënë për tetë për qind, ndërsa nga qymyri 27 për qind. Që nga



viti 2015 pjesa e qymyrit në prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike është përgjysmuar. Kështu, emetimi i gazrave të dëmshëm është zvogëluar ndjeshëm.

Vitin e kaluar për herë të parë vendi hoqi dorë plotësisht nga energjia elektrike nga termocentralet bërthamore. Tre termocentralet e fundit bërthamore u hoqën nga rrjeti në vitin 2023, në kohën kur ato përbënin gjashtë për qind të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike në Gjermani.

Tregu i Bashkimit Evropian për energjinë elektrike

Brenda Bashkimit Evropian vendet do të duhej ta ndihmojnë njëra-tjetrën energjikisht. Kur në Gjermani ka shumë erë dhe diell, ajo eksporton energji, e kur nuk i ka këto kushte, e importon. Gjermania mbulon shumicën e nevojave të saj nga Franca, e cila prodhon 70 për qind të energjisë elektrike në

termocentralet bërthamore. Danimarka është në vendin e dytë, Zvicra në vendin e tretë. Të tre vendet eksportuan dukshëm më shumë energji në Gjermani sesa importuan prej saj me çmimet që formohen në bursë. Çmimi i konsumit të energjisë elektrike në Gjermani rëndohet edhe nga taksat, të cilat përbëjnë 30 për qind të shumës përfundimtare.

Në Gjermani, çmimi është më i shtrenjti

Sipas Entit Federal të Statistikave të Gjermanisë, një familje me tre ose katër anëtarë ka paguar rreth 40 centë për kilovat-orë vitin e kaluar. Në Irlandë dhe Danimarkë ata paguan 37 centë, në Çeki, Belgjikë dhe Itali rreth 33 centë. Në Hungari dhe Bullgari energjia elektrike subvencionohet nga shteti, kështu që konsumatorët paguanin vetëm dhjetë centë për kilovat/orë.

Në Gjermani ka edhe subvencione, por për industrinë. Megjithatë,

kompanitë që përdorin një sasi të madhe të energjisë elektrike ankohen gjithnjë e më shumë për kostot që ulin konkurrencën e tyre.

Në vitin 2021 industria paguante 12 centë për kilovat-orë, por pas sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës, çmimi u rrit në 50 centë. Nga korriku 2022 taksat për kompanitë janë ulur. Ndërkohë çmimi i kilovat-orës është 17 centë. Por edhe kjo është dukshëm më shumë se çmimet që paguajnë kompanitë më të rëndësishme konkurrese në vendet e tjera. Për shembull, në vitin 2023 prodhuesit gjermanë të makinave paguanin dyfishin e çmimit të energjisë elektrike në krahasim me kompanitë konkurrese në Kinë, madje tri herë më shumë se kompanitë të tilla në Shtetet e Bashkuara. Kancelari gjerman Olaf Scholz i propozoi Komisionit të Bashkimit Evropian që t'i autorizojë shtetet anëtare të BE-së për të vendosur subvencione për kompanitë që konsumojnë shumë energji ose prodhojnë bateri.

Demokristianët, të kryesuar nga kandidati për kancelar, Friedrich Mertz, kërkojnë që të përgjysmohen shpenzimet dhe taksat që rrisin çmimin e energjisë elektrike. Ai propozon të ulet taksa për konsumin e energjisë elektrike për kompanitë që varen nga konsumi intensiv, por nuk është e qartë se si do të financohej e gjithë kjo. Megjithatë, është e sigurt se ndërtimi shtesë i burimeve të rinovueshme të energjisë, rrjeteve të energjisë dhe kapaciteteve për ruajtjen e energjisë do të sjellë rritje të kostove për vite me radhë. /DW/

Kosova është përsëri në pishinën e vendeve kandidatë të MCC-së

Prishtinë, 13 janar - Kosova po zbaton një kompakt të Millennium Challenge Corporation MCC prej 236 milionë dollarësh për të krijuar një sektor më të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe më të

besueshëm të energjisë. Kështu ka njoftuar Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë.


Drejtori i vendit Millennium Challenge Corporation - MCC Rinor Gjonbalaj u takua me ministren e Ekonomisë, Rizvanolli, për të njoftuar se

me një rregullim të fundit të pragut të të ardhurave, Kosova është përsëri në pishinën e vendeve kandidatë të MCC-s. "Aktualisht Kosova po zbaton një kompakt të MCC-s prej 236 milionë dollarësh për të

krijuar një sektor më të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe më të besueshëm të energjisë. Një hap para për të ardhmen e ndritur të Kosovës", thuhet në njoftimin e Ambasadës së Gjermanisë.



Frojdi, Niçe, Marksi: Mjeshtrat e Dyshimit



Filozofi francez Paul Ricoeur hodhi dritë mbi mënyrën se si njeriu përpiqet të kuptojë botën e brendshme dhe realitetin e jashtëm. Ai identifikoi dy shtysa themelore në filozofi: “vullnetin për dyshim” dhe “vullnetin për dëgjim”, që janë bazat e Hermeneutikës, apo arti i interpretimit. Sipas Ricoeur, “vullneti për dyshim” përfaqëson nevojën për të tejkaluar mendimin klasik të Dekartit, i cili e bazonte filozofinë mbi idenë e një realiteti të qartë dhe të padyshimtë: Cogito, ergo sum (“Mendoj, pra jam”). Por për filozofët e shekullit XIX, kjo qasje u duk e thjeshtëzuar. Ricoeur i referohet kësaj epoke si “Shkolla e Dyshimit”, një periudhë që hedh poshtë të vërtetat absolute të shoqërisë, shkencës dhe ekonomisë. Ai veçon tre figura qendrore që shpalosën fuqitë e fshehta që

ndikojnë në veprimet njerëzore: Karl Marks, Friedrich Niçe dhe Sigmund Frojd. Këta mendimtarë shpërfaqën mënyrën se si nën sipërfaqen e vetëdijes njerëzore, fshihet një botë e errët dhe komplekse.

Karl Marks: Ekonomia si luftë për pushtet

Marks ndryshoi përgjithmonë mënyrën si e kuptojmë shoqërinë dhe ekonominë. Ai analizoi botën kapitaliste në ngritje, duke vënë në dukje konfliktin midis dy klasave kryesore: borgjezisë (ata që zotërojnë mjetet e prodhimit) dhe proletariatit (ata që shesin fuqinë e tyre punëtore). Për Marks, ky konflikt është zemra e çdo shoqërie kapitaliste dhe shpjegon ndryshimet sociale, politike dhe ekonomike.

Teoria e tij mbi luftën e klasave nuk ishte thjesht një analizë; ajo u kthye në një thirrje për revolucion, duke frymëzuar lëvizje që kanë formësuar historinë e shekullit XX. Njëpërmjet kësaj lenteje, Marks tregonte se fuqitë ekonomike të fshehura i japin formë realitetit tonë, më shumë sesa mund ta kuptojmë.

Friedrich Niçe: Vullneti për pushtet

Niçe sfidoi themelet e moralit dhe filozofisë perëndimore duke propozuar një qasje krejtësisht ndryshe: “vullnetin për pushtet”. Ai besonte se kjo ishte forca më e thellë që shtyn njeriun drejt krijimit, transformimit dhe mbijetesës. Përmes konceptit të tij të “shpirtit dionizian”, Niçe fton të pranojmë jetën me të gjitha kundërshtitë e saj, duke kaluar

përtej kufizimeve të moralit tradicional dhe dogmave shoqërore. Megjithatë, ai gjithashtu paralajmëroi për rrezikun e shkatërrimit të këtij vullneti nga normat e ngurta që e zbehin origjinalitetin njerëzor.

Sigmund Frojd: Misteret e pavetëdijes



Frojdi, babai i psikoanalizës, revolucionarizoi mënyrën se si e kuptojmë mendjen njerëzore. Ai zbuloi se sjelljet dhe mendimet tona shpesh drejtohen nga forca të pavetëdijshme – konflikte, komplekse dhe dëshira që nuk i pranojmë hapur. Për Frojd-in, pavetëdija nuk është thjesht një hapësirë e errët, por një burim krijimtari dhe tensioni. Ai demonstroi se kjo botë e fshehur ndikon në artin, letërsinë, dhe çdo formë

të shprehjes njerëzore. Psikoanaliza e tij jo vetëm që transformoi psikologjinë, por u bë një instrument për të kuptuar më mirë shoqërinë moderne.

Triumfi i dyshimit

Marks, Niçe dhe Frojd na lanë një trashëgimi të përbashkët: ata shkatërruan iluzionin e një të vërtete absolute dhe universale. Ata mbollën dyshimin, pra atë vullnetin për të hetuar thellësisht arsyet e fshehura pas çdo bindjeje dhe veprimi.

Këta “mjeshtra të dyshimit” na mësuhan se njeriu është më kompleks dhe më i mistershëm sesa duket. Njëpërmjet tyre, bota nuk është më një hapësirë e qartë dhe lineare, por një mozaik i pasur interpretimesh dhe sfidash, ku e vërteta është gjithmonë në diskutim. / bota.al



Gjilani liron dy futbollistë

GJILAN, 13 JANAR - Gjilani ka liru dy futbollistë gjatë janarit, Arbër Mustafën dhe Eldonit Shaqirin. Sipas njoftimit të këtij klubi, Mustafa dhe Shaqiri ishin shembull i profesionalizmit dhe përkushtimit të treguar në punë. "Sport Club Gjilani

njofton se ka liru me mirëkuptim futbollistët Arbër Mustafa dhe Eldonit Shaqiri. Në kërkim të hapësirave për të luajtur më shumë, klubi ka mirëkuptuar futbollistët dhe ka ndarë rrugën e bashkëpunimit. Sikurse Mustafa, po ashtu edhe Shaqiri ishin shembuj të

profesionalizmit dhe përkushtimit të treguar në punë. Gjilani i falënderon Arbërin dhe Eldonitin për kontributin e dhënë gjatë kohës sa ishin pjesë e klubit, ndërkohë që u uron shumë suksese në angazhimet e tyre të reja sportive", ka njoftuar Gjilani.



"Edon Zhegrova është i etur për t'iu bashkuar Napolit"



PRISHTINË, 13 JANAR - Sulmuesi Edon Zhegrova ka dëshirë për t'iu bashkuar Napolit në këtë afat kalimtar të janarit. Mediet italiane kanë raportuar se ylli i Kosovës është i etur të luajë nën urdhrat e Antonio Conte dhe të bëhet bashkëlojtar me Amir Rrahmanin. Megjithatë, problemi kryesor mbetet Lille. Skuadra franceze është duke refuzuar ta shesë Zhegrovën, por edhe nëse ndryshon mendje, atëherë do të kërkojnë rreth 30 milionë euro për kartonin e kosovarit. "Lille

ende nuk është e hapur për shitjen e mundshme të Edon Zhegrovës. Lojtari e ka dëshirën e çmendur për t'iu bashkuar Napolit. Ai dëshiron të largohet në Ligën 1. Mundësia për të luajtur me kapitenin Amir Rrahmani po e ngre edhe më shumë këtë dëshirë dhe e tondon të përfundojë te Napoli. Fakti që është majtak shton disavantazh, edhe pse drejtori sportiv i Napolit e vlerëson shumë. Çmimi i tij shkon 25-30 milionë euro", raporton gazeta

italiane "Corriere dello Sport". Sipas kësaj gazete, Napoli mund të insistojë sërish për shërbimet e Zhegrovës dhe të nisë një ofertë zyrtare në javët e ardhshme. Zhegrova është duke vazhduar shkëlqimin te Lille, ku këtë sezon ka shënuar tetë gola në Ligën e Kampionëve dhe Ligën 1, derisa ka të regjistruar edhe dy asistime. Te Napoli, Zhegrova shihet si pasuesi adekuat për Khvicha Kvaratskhelia, me këtë të fundit që po shkon drejt PSG-së.

Daku "sheh" kah Italia, sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë shton polemikat në Rusi

PRISHTINË, 13 JANAR - Në futboll ndodh çdo gjë, ndaj edhe nuk duhet të habitemi lehtë. Rreth Mirlind Dakut ka pasur spekulime të shumta, mbi një kalim të mundshëm në Itali, Gjermani apo në ndonjë ekip tjetër të Premierë Ligës së Rusisë, dhe këto histori po përsëriten. Medieve ruse nuk u ka shpëtuar fotografia e sulmuesit të kombëtares me fanellën e Atalantës, ekipit ku luan kapiteni kuqezi, Berat Gjimshiti. Po ashtu, në medie online



"Veçernaja Kazanj" është shfaqur fotoja e makinës së Dakut me flamurin trengjyresh italian, dhe menjëherë është hedhur ideja se ai mund të shkojë në Serinë A. Dyshimet janë për te Cagliari, ndonëse bluza që veshi 27-vjeçari ishte ajo zikaltër e Atalantës. Për momentin shqiptari është me pushime, ashtu si lojtarët e tjerë të Rubinit, sepse Premierë Liga ruse është ndërprerë për shkak të dimrit, dhe faza përgatitore e kësaj stine ende nuk ka nisur.

Daku ishte lojtari më i mirë i Rubinit, po ashtu u shpall "Personaliteti Sportiv" i vitit në Republikën Autonome të Tatarstanit, përveçse ishte më i mirë në elitën ruse për kontributin për golat në 2024-n, me 15 rrjeta e 9 asistime. Ai ka thyer rekordin e klubit në këtë statistikë, ndërsa besohet se interesim për shërbimet e tij ka pasur nga Spartaku i Moskës apo Krasnodari, e një mendim e ka pasur Zeniti. Rubini kërkon nga 12 deri në 18 milionë euro për kartonin e tij.

Ancelotti: Veç Mbappe e kaloi "provimin"

MADRID, 13 JANAR - Carlo Ancelotti ka mbetur i zhgënjyer me lojtarët e tij pas humbjes së thellë nga Barcelona me rezultat 2:5 në ndeshjen finale të Superkupës së Spanjës. Sidoqoftë, është një lojtar i Real Madridit që e ka kaluar "provimin" te trajneri italian të dielën mbrëma, në ndeshjen e zhvilluar në Arabinë Saudite. "A kishte diçka të mirë në këtë lojë? Asgjë përpos paraqitjes së Mbappes. Luajti mjaft mirë,

bëri aksione të shkëlqyeshme, shënoi. Për pjesën tjetër duhet ta harrojmë këtë lojë dhe të shikojmë përpara", ka thënë Ancelotti në konferencën për medie, duke komentuar lojën me gjigantin katalunas. "Duhet të përballemi me realitetin. Nuk jemi mbrojtur mirë. Ata na shënuan gola shumë lehtë. Nuk arritëm të punonim as kolektivisht e as individualisht, sepse humbëm shumë duele. Por, kështu e ka futbollin. Jemi të

trishtuar dhe të dëshpëruar, e bashkë ndiejmë trishtimin e tifozëve tanë, por duhet të shikojmë kah e ardhmja sepse na presin sfida të tjera. Duhet të këndellemi dhe ta rimarrim veten. Mund të ndodhë që të humbim ndeshje, por jo siç luajtëm në pjesën e parë. Mendoja se pas ndëshkimit me karton të kuq të Szczesnyt do të mund të riktheheshim në lojë, por as me superioritetin numerik nuk ia dolëm të gjenim zgjidhje", ka theksuar Ancelotti.



Tash Reali do të mundohet ta harrojë këtë humbje dhe të fokusohet në kampionatin

spanjoll dhe në Ligën e Kampionëve përmes të cilëve mund ta shpëtojë sezonin.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shkumbim Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.u. "Zekeria Rexha". Informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Përparim Ahmetaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- Fatlind Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Fazli Memcaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Fatime Rexha shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Ilir Bytyqi shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi " Prizren.
- Mimoza Durakaj shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.
- Eljesa Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të Gjimnazit "Hajdar Dushi".
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në: 044/706-079.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

